



INFORMACIONE

15 NËNTOR-31 DHJETOR 2005

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR



Udhëtimi i Flakës Olimpike 2006 vazhdon...



8 Dhjetor – Presidenti i KOKSH mbajtës i Flakës Olimpike "Torino 2006".

8 Dhjetor – Presidenti i KOKSH mbajtës i Flakës Olimpike "Torino 2006".

Flaka Olimpike e cila është nisur nga Greqia për të bërë turin mbarë kontinental dhe për tu kthyer në Itali në kuadër të organizimit të Lojrave Olimpike Dimërore "Torino 2006" ka pasur nderin ta mbajë edhe Presidenti i KOKSH z. Hysen Domi. Në qytetin e Romës në Itali, Presidenti Domi i cili mbante numrin 10233 të mbajtësve të Pishtarit Olimpik ka përshkuar një distancë prej 350m dhe përfundimi i mbajtjes së pishtarit për t'ia dorëzuar atë një mbajtësi tjetër ishte në Universitetin "La Sapienza" të Romës. Cituar nga "Sporti Shqiptar"

18 Nëntor – Femra dhe Sporti, Mbledhje e Komisionit

Komisioni “Femra dhe Sporti” i KOKSH, në hollin e Mbledhjeve të KOKSH, zhvilloi mbledhjen e dytë të radhës, në rendin e ditës të së cilës ishin:

-Pjesëmarrja e dy përfaqësuesve të Komisionit në Seminarin Rajonal “Femra dhe Sporti” zhvilluar nën patronazhin e CIO më 27-29 Tetor, në Stamboll, Turqi.

-Ngritja e Grupit të punës për Konferencën e III Kombëtare “Femra dhe Sporti”

23 Nëntor – Sekretari i Përgjithshëm i Fed. Europiane të Peshëngritjes, vizitë në KOKSH.

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello, priti në një takim pune në KOKSH Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës Europiane të Peshëngritjes z. Marino Ercolani Kazadei, i shoqëruar nga homologu i tij Shqiptar z. Ilir Kraja. I mbërritur në Shqipëri në kuadër të një vizite pune me ftesë të FSHP, dhe Presidentit të saj z. Esat Ademi, në takim u diskutua në frymën e kërkesës për mbështetje në kuadër organizimit të Kampionatit European të peshëngritjes për të rinjë i cili parashikohet të zhvillohet në Pranverën e vitit 2006. z.Bello theksoi se “KOKSH tashmë e ka pjekurinë e tij dhe është i bindur në eksperiencën që ka fituar në mbështetje të aktiviteteve ndërkombëtare të organizuara në Shqipëri. Pra padyshim që KOKSH është i hapur të bashkëpunojë e të



21 Nëntor – Pritje në KOKSH përfaqësues të Taekwondo dhe “SunRay Team”.



Delegacioni Korean i sportit të Taekwondos “SunRay Team” të shoqëruar nga z. Përparim Ferunaj, Pedagog i AEFS “Vojo Kushi” bënë një vizitë në zyrat e KOKSH të cilët u pritën nga Sekretari i Përgjithshëm z. Stavri Bello. Në këtë takim, u fol për mundësitë e bashkëpunimit për lehtësimin e punës së komunitetit sportiv i cili merret me këtë sport, ku nga ana e Sekretarit Bello për KOKSH u tha se do të jepet mbështetja e nevojshme zyrtare për lehtësimin e hapave për një stërvitje më të organizuar të sportistëve të këtij sporti në Shqipëri. Dhurata simbolike nga të dy palët dhe një fotografi e përbashkët përmbyllën këtë takim.



mbështesë këtë iniciativë europiane. Federata Shqiptare e Peshëngritjes është federata që i ka dhuruar më shumë medalje ndërkombëtare Shqipërisë dhe si e tillë gëzon një status konsiderate të lartë nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar”.

Ditën e nesërme u vijua me Konferencën për Shtyp, në Hotel Tirana International dhe me nderimet përkatëse protokollare për zotin Kazadei.

Kurset Rajonalë të Administratorëve të Sportit (Tirana; Gjirokastra)

Duke vazhduar tashmë Programet e konsoliduar financiar nga Solidaritetit Olimpik edhe për periudhën 2005-2008, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar organizoi në Kursin Lokal të Administratorëve të Sportit të Bashkisë Tiranë. Dhe një muaj më vonë atë të prefekturës Gjirokastrë.

Qëllimi i kursit vijon të jetë rritja e njohurive dhe informimi i Drejtuesve e Menaxherëve, aktualë dhe të mundshëm të Sportit, me koncepte bazë mbi administrimin dhe menaxhimin në sport, e parë në planin administrativ, ligjor, ekonomik etj., njohja me eksperiencën e metoda praktike të cilat kanë dhënë rezultate, si dhe me edukimin e rinisë me frymën e Olimpizmit.



Z. Robert Mane duke lektuar në seancë seminari

23-25 Nëntor, Tirana: Pjesëmarrësit në këtë kurs ishin drejtues të institucioneve sportive publike dhe private, tranjer, pedagogë të AEFS "Vojo Kushi", studentë, mësues të edukimit fizik, specialistë dhe përfaqësues të Organizmave lokalë. Presidenti i KOKSH Hysen Domi, Rektori i AEFS "Vojo Kushi" z. Sejfulla Shtëpani mbajtën fjalën e hapjes dhe përcollën mesazhin e tyre në këtë kurs, i cili drejtua nga 3 prej lektorëve Kombëtarë të aprovuar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, por gjithashtu lektuan lektorë të tjerë të ftuar nga KOKSH në kuadrin e këtij kursi.

22-24 Dhjetor, në Qytetin e Gjirokastrës, u zhvillua Kursin Lokal të Administratorëve të Sportit të Prefekturës së Gjirokastrës, duke përfshirë qytetet e Gjirokastrës, Përmet, Tepelenë dhe Sarandë. Për nga interesi i këtij kursi, Prefekti i Qarkut Gjirokastrë mori pjesë në ceremoninë e hapjes dhe Certifikimit të Kursantëve.

Pjesëmarrësit në këtë kurs ishin drejtues nga organizmat sportivë publikë dhe privatë, trainerë, mësues të edukimit fizik, specialistë dhe përfaqësues të Organizmave lokalë."



Foto e përbashkët e pjesëmarrësve, i pranishëm Prefekti i Gjirokastrës.

23 Nëntor – Shqipëria në “Torino 2006” Takim me Zv. Ministrin e MTKRS

Zv. Ministri i MTKRS Neritan Alibali dhe stafi i Drejtorisë së Sportit në MTKRS, priti në një takim pune në kuadër të mbështetjes së pjesëmarrjes së Shqipërisë në Lojrat Olimpike Dimërore “Torino 2006”, Presidentin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të KOKSH. Në këtë takim ku i pranishëm ishte edhe Drejtori i Përgjithshëm i Bankës Popullore z. Edvin Libohova. KOKSH prezantoi Draftin e Projektit të Financimit të Pjesëmarrjes së Shqipërisë në “Torino 2006” dhe një panoramë kronologjike dhe të buxhetit të të gjitha aktiviteteve që do të shoqërojnë këtë moment kompleks në historinë e Lëvizjes Olimpike Shqiptare, pikërisht pjesëmarrjen e parë në Lojrat Olimpike Dimërore të një Sportisti Shqiptar.



25 - 30 Nëntor “Klik Expo Klik 2005” KOKSH Promovon “TORINO 2006”

Për 5 ditë radhazi, KOKSH & Partnerët promovuan skiatorin dhe Pjesëmarrjen e Parë të Shqipërisë në Lojrat Olimpike Dimërore “Torino 2006”. Ky promovim u ilustrua me Stenda – Postera – Ilustrime me DVD, të cilat Promovojnë Skiatorin Erion Tola si dhe DVD e Fushatës “Celebrate Humanity” të CIO me Nelson Mandella dhe Andrea Bcelli si ambasadorë.

Kompania Coca Cola mbështeti me produktin e saj në këtë stendë për të ofruar të gjithë miqve vizitorë në stendë, si dhe dhe me stafin promociional që ishte gjithmonë i pranishëm.

Zv. Ministri i MTKRS z. Neritan Alibali – Presidenti i KOKSH z. Hysen Domi Drejtori i Sporteve në MTJRS z. Mehmet



Spahiu, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello, Federata Shqiptare e Skive, përfaqësues të Biznesit e të Medias, dhe dashamirës të Sportit kanë promovuar mbështetjen e gjërë dhe të shumëllojshme që ka startuar dhe që pritet të konkludohet me grumbullimin e fondeve që mundësojnë përgatitjen e Skiatorit në Garat e tjera Kualifikuese të të tjerave disiplina të Skive në “Torino 2006”, edhe në Panairin “Klik Ekspo Klik” – Pallati i Kongreseve, në Stendën Olimpikë, e cila është mundësuar në partneritet me ‘Klik Ekspo Group’.





5-6 Dhjetor KOKSH Fton në Shqipëri Skiatorin Erjon Tola

Ai Pritet nga Zv. Ministri i MTKRS z. Neritan Alibali i Shoqëruar nga Presidenti i KOKSH Hysen Domi dhe Presidenti i FSH Ski z. Shkëlqim Mema. Për t'u prezantuar edhe publikut, në KOKSH u dha një Konferencë e Përbashkët për Shtyp. Me praninë edhe të Presidentes së Coca Cola Shqipëri zj. Kristina Busi dhe Drejtorit të Sporteve në MTKRS z. Mehmet Spahiu. Gjatë Vizitës së tij, skiatori pati ftesa të dedikuara nga TVSH dhe intervistua gjerësisht në median sportive. Konferencë Për Shtyp "KOKSH - Coca Cola – Athlete – MTKRS – Federata Kombëtare e Skive".

15 Dhjetor Tryeza e Rrumbullaket me Biznesin MTKRS – KOKSH – FSHSki



Z. Luan BREGASI/President (Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë)
 z. Bashkim SALA / Anëtar i Bordit Asamblesë përfaqësuese së DHTI
 z. Edvin LIBOHOVA / Drejtor i Përgjithshëm/ Banka Popullore
 z. Myslym Ndoj & Shkëlzen Margjeka / Kompania e Sigurimeve
Eurosig (ishDukagjini)

Me praninë e Zv. Ministrin të MTKRS z. Neritan Alibali, Presidentit të KOKSH z. Hysen Domi, Presidentit të Federatës Shqiptare të Skive z. Shkëlqim Mema, shprehin konsideratën për praninë dhe angazhimin e Komunitetit të Biznesit në Tryezën e Rrumbullakët me objekt 'SHQIPERIA në Lojrat Olimpike Dimërore "TORINO 2006", prezantuan propozimin për mbështetjen financiare përfaqësuesve të komunitetit të Biznesit, për të marrë feedback dhe informacion mbi shprehjen e interesit të paleve.



2-3 Dhjetor Asamblea Zgjedhore e COE – Dublin, Irlandë

Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, morën pjesë në Asamblenë e Përgjithëshme Vjetore të 34 të Komitetit Olimpik Europian (COE) e cila u zhvillua në Dublin të Irlandës. Përveç përfaqësuesve të 48 Komiteteve Olimpikë anëtare të COE, morën pjesë Presidenti i CIO z. J. Rogge dhe anëtarë të CIO të cilët u përshëndetën nga Presidenti i COE z. M. Pescante. Në këtë ngjarje të rëndësishme të Familjes Europiane ishin të pranishëm Kryeministri dhe Ministri i Sportit të Irlandës, Princi Albert II i Monacos të cilit iu dha nga COE Urdhëri i Meritës për kontributin e tij në Sport dhe promovimit të vlerave Olimpikë.

Por fokusi kryesor në këtë Asamble ishte zgjedhja e Komitetit Ekzekutiv të COE e cila do të drejtojë Organizatën për 4 vjeçarën e ardhshme (2006-2009). Asamblea konfirmoi në postet e tyre: President Mario Pescante, zv/President Alexander Kozlovsky, Sekretar të Përgjithshëm Patrick Hickey, gjithashtu sipas procedurës u zgjodhën Anëtarët

e Komitetit Ekzekutiv. Asambleja e Përgjithëshme Vjetore e 35-të do të mbahet në 8-9 Dhjetor 2006 në Bruksel të Belgjikës.

4-6 Dhjetor 2005 - Konferenca e 2-të “Zhvillimi nëpërmjet Sportit” Makolin/Zvicër

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello, mori pjesë në Konferencën e 2-të “Sporti dhe Zhvillimi” e cila u zhvillua në Makolin (Maggingen) të Zvicrës. Më shumë se 400 pjesmarrës nga 70 vende të botës kërkuan angazhim më të madh nga të gjithë aktorët e kësaj konference për të përshatur në ditët e sotme një Thirrje për Veprim, duke marrë vendim që të përdorin sportin për të rritur cilësinë e edukimit, arsimimit dhe shëndetit, për të shkatëruar varfërinë; për të promovuar dhe inkurajuar paqen dhe tolerancën. Thirrja për Veprim e Konferencës së Maggingen i drejtohet organizatave sportive, sportistëve, qeverive, agjensive zhvilluese, sektorit privat, medias dhe sipërmarrësve të tjerë socialë. Duke u kërkuar të përdorin dhe të promovojnë aktivisht sportin si një mjet për zhvillim në fushat e tyre respektive të veprimit.

5-15 Dhjetor 2005 KOKSH – SO Kursi Teknik i Kualifikimit të Trajnerëve të Basketbollit.

Mbështetur në Pro-KOKSH kohët e funzimitin e projektit të mjaft ambicioz në atave të sporteve boll dhe Volejboll të Projekti i cili shtrihet 4 vjeçare synon zhdushëm të trabollit dhe Volejbollit stalimin e këtij sistemi përkatëse. Në vijim KOKSH nga data 5-



në bashkëpunim edhe me Federatën Shqiptare të Basketbollit ka organizuar Kursin e parë Teknik të Kualifikimit të Trajnerëve të Basketbollit. Për të drejtuar këtë kurs, Solidariteti Olimpik në bashkëpunim me FIBA kanë dërguar në Shqipëri ekspertin italian të FIBAs z. Mario De Sisti i cili drejtoi intesivisht kursin për 11 ditë me nga 2 seanca. 25 pjesmarrësit e propozuar nga FSHB të ardhur nga qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe me një moshë relativisht të re, përmbushën mesëmiri moisionin e kursit i cili do të pasohet me një nivel më të avancuar për 2006. Në tremujorin e parë të 2006 parashikohet të zhvillohet kursi i parë për specialitetin e Volejbollit.

gramet e SO, dit ka nisur real-rëndësishëm dhe mbështetje Feder-kolektive Basket-financuar nga SO. në një periudhë kualifikimin e vajnerëve të Basket-dhe njëkohësisht in-pranë Federatave të këtij projekti, 15 Dhjetor 2005,

12 Dhjetor – Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH

Objekt i punës në këtë mbledhje ishin pikat për diskutim sipas rendit të ditës:

- Shqipëria në Lojrat Olimpikë Dimërore Torino 2006” – KOKSH dhe Partnerët.
- Bursat Olimpikë Pekin 2008” – Starton Projekti / Raport mbi Aplikifthin e KOKSH
- Projekte Speciale:
- Mobilimi i zyrave të KOKSH – projekt i financuar nga Komiteti Olimpik Europian
- Dixhitalizimi i Arkivave të KOKSH – Financuar nga Solidariteti Olimpik
- SO - Financime të përfutuara dhe projekte në Progres për Kualifikimet e Trajnerëve
- Informacion mbi punën dhe Mbledhje të Komisioneve të KOKSH



Akademia Olimpikë Shqiptare (AOSH)

21 Dhjetor – AOSH, Sesioni i 9-të vjetor “Olimpiada e Bardhë”



Aktiviteti u organizua duke iu referuar tërësisht ngjarjes më të madhe Olimpikë “Torino 2006”, AOSH me mbështetjen e KOKSH, organizoi në “Hotel Tirana International”.

Kumtesat e prezantuara nga Anëtarët e bordit të AOSH kishin në fokus “Torino 2006”. Lojrat Olimpikë Dimërore, dimensionin e tyre Agron Cuka

*Olimpiada Kulturore Përparim Ferunaj
Sporti për të Gjithë në Lojrat Olimpikë Ilia Gaxho
Teknologjia në Funkcion të Lojrave Olimpikë Kliton Muca
Paketa Olimpikë-Edukimi Olimpik në Shkollë
Bardhyl Misja – Arben Kaçurri*

14 Dhjetor —AOSH Sesioni i 5-të vjetor i të Rinjëve

Ky sesion u zhvillua në auditorin e leksioneve të Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”. Sesioni, i cili synon të promovojë vlerat Olimpikë, nxori në pah punën e pavarur kërkimore të studentëve të AEFS “Vojo Kushi”, ku Kumtesat të cilat u referuan në Sesion ishin përgatitur nga vetë studentët të AEFSs dhe u ndoqën nga një pjesmarrje e gjerë e përfaqësuesve të institucioneve sportive në vend.

*Lojrat Olimpikë në Greqinë e vjetër, Kelvin PEPA
Olimpia e lashtë dhe Lojrat Olimpikë, Elton DERVENI
Kultura & Edukimi në Lëvizjen Olimpikë,
Gentiana QOSE
Refleksione mbi agresionin në sport, Rudina SHEHI
Dimensionet e Solidaritetit Olimpik, Najada SHORE*



14 dhjetor 2005 “PEKIN 2008” – Aplikimi per Bursat Konferencë Shtypi & Ceremoni e Nenshkrimit te Kontratave te Kandidimit. Në hotel “Mondial”, BURSAT OLIMPIKE – Kandidatët për Aplikim Nënshkruajnë kontratën e Kandidimit. Në vijim të plotësimit të kritereve të Aplikimit për në CIO dhe Solidaritetin Olimpik për Bursat Olimpikë



“Pekin 2008”, Nënshkrimin e Kontratave të Kandidimit për në CIO mes KOKSH - Federatës Kombëtare Sportive – Kandidatit (ose perfaqesuesit ligjor te tij). Komisioni Teknik i KOKSH sot ne ora 13:00 do të bëjë vlerësimin e dokumentacionit dhe rezultateve të kandidatëve për prioritizimin e tyre në listë, dhe më pas do të jetë ceremonia e nënshkrimit të Kontratave.

**SPORTISTËT OLIMPIKË MUNDËSOJNË ENTUZIAZMIN.
SPONSORËT OLIMPIKË MUNDËSOJNË MBËSHTETJEN.
SË BASHKU, ATA MUNDËSOJNË ENDRREN.**

Pavëresisht kësaj, disa kompani do të hiqen sikur janë sponsorë Olimpikë ose të krijojnë përshypjen jo të vërtetë sikur janë. Ata që e bëjnë këtë, vënë në lojë ëndrrën. Duke përdorur imazhet ose emblemat Olimpikë të pautorizuara, ose duke prezantuar veten e tyre sikur kanë një lidhje zyrtare me Lojrat Olimpikë, këto kompani çenojnë të ardhmen e Lojrave Olimpikë.

Vetëm Sponsorët Zyrtarë Olimpikë kanë të drejtë të përdorin emblemat dhe imazherinë Olimpikë në reklamat e tyre. Një e drejtë kjo, të cilën ata e kanë përfituar duke mundësuar produktet, shërbimet dhe mbështetjen financiare, e cila ndihmon që të bëhen të mundura Lojrat Olimpikë.

Me afrimin e shpejtë të Lojrave Olimpikë Torino 2006, tregoni mbështetjen tuaj për kompanitë që janë Sponsorë Zyrtarë Olimpikë dhe që janë liçensuar zyrtarisht. Faleminderit.

THE WORLDWIDE OLYMPIC PARTNERS / PARTNERË MË SHTRIRJE BOTËRORE



SPONSORËT LOKALË NË SHQIPËRI

Së shpejti do të jenë këtu.....